


Udhëzuesi për komunikim dhe vizibilitet

Bashkëfinancuar nga:



Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

PËRMBAJTJA

HYRJE	3
KËRKESAT	4
Kanalet e komunikimit dhe promovimi	4
Shtypi dhe media	4
Njoftimi për shtyp	4
Konferencat për shtyp	4
Materialet e shtypura	5
Komunikimi dhe vizibiliteti në internet	5
Fushatat dhe aktivitetet informuese	6
Materialet audio-vizuele, fotografitë dhe botimet tjera	6
IDENTITETI VIZUEL	7
Klauzola e përkrahjes	7
Klauzola e përkrahjes për grantistët institucional	7
Klauzola e përgjegjësisë	8

Hyrje



Ky udhëzues ka për qëllim të udhëzojë dhe të ndihmojë grantistët për komunikim dhe promovim të duhur të aktiviteteve të përkrahura nga programi Angazhimi për Veprim të Përbashkët “EJA Kosovë”.

Ky udhëzues është pjesë integrale e kontratës prandaj grantistët janë të detyruar të respektojnë kërkesat e specifikuara në këtë dokument. Për çdo pyetje ose informacion shtesë, grantistët duhet të kontaktojnë me zyrtarin/en përgjegjës/e për grantin e tyre nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF).

Për ilustrim të disa prej kërkesave të këtij udhëzuesi, referojuni shtojcës me modele.

Për të gjitha kërkesat që nuk janë të rregulluara në këtë udhëzues, KCSF do të bëjë çdo përpjekje për t’iu përgjigjur sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se 5 ditë pune. Në raste të jashtëzakonshme, KCSF rezervon të drejtën për të zgjatur këtë afat. Në raste të tilla, KCSF do të përkujdeset që të informojë grantistët në kohën e duhur.

Kërkesat

Grantistët janë përgjegjës për komunikimin dhe promovimin adekuat të aktiviteteve dhe rezultateve që janë pjesë e grantit të përkrahur nga programi “EJA Kosovë”.

Si rregull i përgjithshëm, aktivitetet dhe rezultatet duhet të promovohen në përputhje me metodologjinë për vizibilitet dhe ndërlidhje me grupet e qytetarëve/publikun të paraqitur në fazën e aplikimit. Gjatë realizimit të kësaj, kërkesat e paraqitura më poshtë duhet të respektohen.

Edhe pse e drejta e autorit e çdo materiali të prodhuar mbetet te grantisti, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Suedia) dhe Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) rezervojnë të drejtën për të përdorur dhe promovuar materialet dhe produktet e komunikimit dhe vizibilitetit, gjatë zbatimit dhe pas përfundimit të granteve të përkrahura. Për më tepër, entitetet e mësipërme do të kenë të drejtë të përdorin dhe riprodhojnë të gjitha publikimet dhe produktet audio-vizuele pa pasur nevojë për leje ose kërkesë për pagesë.

Kanalet e komunikimit dhe promovimit

Përveç komunikimit dhe promovimit të aktiviteteve të zbatuara, grantistët duhet të synojnë të shtojnë edhe promovimin e rezultateve dhe rasteve të suksesit. Qëllimi i komunikimit dhe promovimit nuk është thjeshtë informimi rreth aktiviteteve të zbatuara, por shkon përtej në sigurimin e transparencës së punës dhe mbi të gjitha frymëzimin e të tjerëve që të bëhen aktiv dhe të ndërmarrin veprime të ngjashme. Duke bërë këtë, grantistët duhet të zgjedhin me kujdes metodologjinë dhe qasjen adekuate të promovimit në mënyrë që të përshtaten me audiencën e synuar dhe interesat e tyre.

Shtypi dhe media

Njoftimi për shtyp

Dokumenti duhet të përmbajë klauzolën e përgjegjësisë që gjendet në seksionin “Identiteti Vizuel”. Për qëllime informimi, të gjitha njoftimet për shtyp duhet t’i dërgohen në mënyrë elektronike përgjegjësit/es të grantit nga KCSF. Në çdo rast, grantisti mban përgjegjësinë për përmbajtjen e njoftimit për shtyp.

Konferencat për shtyp

Përveç rasteve të jashtëzakonshme që kanë nevojë për një reagim të shpejtë dhe konferenca për shtyp duhet të organizohet urgjentisht, KCSF duhet të njoftohet të paktën tre ditë më herët. Ftesat duhet të përmbajnë klauzolën e përkrahjes që gjendet në seksionin “Identiteti Vizuel”.

Materialet e shtypura

Informata mbi grantin, fletushkat, broshurat dhe buletinët, prezantimet në Power Point

Në përgjithësi, materialet e shtypura siç janë informata mbi grantin (factsheet), fletushkat, broshurat dhe buletinët, duhet të dërgohen edhe në formatin elektronik në mënyrë që të postohen në faqet e internetit, mediat sociale dhe të shpërndahen më lehtë te palët e interesuara. Të gjitha materialet e shtypura duhet të përmbajnë logot e SDC-së, Suedisë, dhe KCSF-së si dhe klauzolën e përgjegjesisë të paraqitura në pjesën më adekuate duke bërë të mundur identifikimin e lehtë të tyre.

Prezantimet në Power Point (të shtypura dhe elektronike) duhet të përmbajnë logot e SDC-së, Suedisë, dhe KCSF-së në pjesën e poshtme të faqes së parë, si dhe **klauzolën e përgjegjesisë** në faqen e fundit (përmbyllëse).

Banerat (të shtypur dhe elektronik) duhet të përmbajnë logot e SDC-së, Suedisë dhe KCSF-së, si dhe **klauzolën e përkrahjes**, në fund të banerit.

Në aktivitetet publike të grantit që përfshijnë përfituesit e synuar dhe/ose pjesëmarrës të jashtëm, baneri duhet të vendoset gjithmonë në një vend të dukshëm.

Grantistët duhet të marrin parasysh përgjegjësinë e tyre për mjedisin përpara se të shtypin çfarëdo materiali promovues dhe vizibiliteti. Materialet e tilla mund të shtypen vetëm nëse asnjë mënyrë tjetër e promovimit nuk mund të arrijë rezultate të ngjashme. Nëse materialet e shtypura janë të nevojshme, ato duhet të shtypen në sasinë minimale të kopjeve të nevojshme për të arritur qëllimin përkatës të promovimit.

Komunikimi dhe vizibiliteti në internet

Faqe të internetit, artikuj, buletinë, blogje

Informacioni që do të promovohet përmes kanaleve në internet, përfshirë mediat sociale, duhet të përmbajë gjithmonë klauzolën e përkrahjes që gjendet në seksionin e Identitetit Vizuel.

Faqja e internetit e grantistit duhet të përmbajë logot e SDC-së, Suedisë dhe KCSF-së. Logot e donatorëve respektiv duhet të lidhen me webfaqet e donatorëve.¹ Nëse dizajni i të gjithë faqes në internet ose i ndonjë nënseksioni mbështetet nga granti, grantisti duhet përfshijë klauzolën e përkrahjes në faqen e internetit ose linkun përkatës.

Gjatë botimit të **artikujve, buletinëve dhe blogjeve**, klauzola e përgjegjesisë duhet gjithashtu të paraqitet dhe të vendoset në pjesën më adekuate duke e bërë të mundur identifikimin e lehtë.

Kur informacioni do të shtypet edhe në letër, përveç klauzolave të cekura më sipër, duhet të paraqiten edhe logot e SDC-së, Suedisë dhe KCSF-së.

Mediat sociale: Ne presim që grantistët e EJA Kosovë të ndajnë në mënyrë aktive informacionet e vlefshme me KCSF-në duke përdorur hashtagun @KCSF kur promovojnë aktivitetet e tyre në Facebook, Instagram, Twitter, LinkedIn ose media të tjera sociale. Aktivitetet e lansimit, konferencat, inaugurimet, punëtoritë e rëndësishme, publikimi i studimeve, dhe në veçanti rezultatet dhe historitë e suksesit - përfshirë ato nga përfituesit e synuar - të gjitha konsiderohen momente të vlefshme për lajme. Ju lutemi dërgoni një tekst të shkurtër (maksimumi 300 fjalë) dhe fotot/videt përkatëse (të realizuara gjatë ngjarjeve të cekura mësipër) tek zyrtari/ja përgjegjës/e nga KCSF.

¹ SDC: <https://www.eda.admin.ch/sdc>
Suedia: <https://www.Sida.se/English/>
Luksemburgu: <https://cooperation.gouvernement.lu/en/partenaires/pays-a-projet/kosovo.html>
KCSF: <https://www.kcsfoundation.org/>

Fushatat dhe aktivitetet informuese

Materialet që do të përdoren në **fushatat informuese** duhet të përmbajnë gjithmonë klauzolën e përkrahjes së bashku me logot e SDC-së, Suedisë dhe KCSF-së. Kur materialet përmbajnë informacion përtej atij të përgjithshëm për grantin², duhet të përfshihet edhe klauzola e përgjegjësisë.

Kur organizojnë **aktivitete** publike, grantistët duhet të sigurohen që kërkesat e identitetit vizuel të adresohen siç duhet. Në varësi të shtrirjes së synuar, grantistët duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të siguruar mbulimin e duhur mediatik. Kur pjesëmarrja e donatorëve dhe përfaqësuesve të KCSF-së është e nevojshme, datat e aktiviteteve publike duhet të caktohen gjithmonë në koordinim me KCSF-në.

Materialet audio-vizuele, fotografitë dhe botimet tjera

Prodhimet audio-vizuele duhet të përmbajnë klauzolën e përkrahjes, logot e SDC-së, Suedisë dhe KCSF-së, dhe, kur është e zbatueshme, klauzolën e përgjegjësië në fillim ose në fund. Grantistët duhet të sigurojnë që kopjet në formatin e tyre përfundimtar për shpërndarje të dorëzohen në KCSF për aprovim paraprak.

Fotografi të aktiviteteve të grantit, ngjarjeve dhe të tjera, duhet të bëhen sa herë që është e mundur në mënyrë që aktivitetet dhe rezultatet e grantit të dokumentohen dhe të përdoren në çdo material komunikimi. Grantistët duhet të sigurojnë që kopjet në formatin përfundimtar profesional të dërgohen në KCSF. Fotografi të cilësisë së mirë duhet të bëhen rregullisht për qëllime komunikimi, si për nevojat e programit EJA Kosovë ashtu edhe për donatorët. Pozimi dhe fotografitë e aranzhuara posaçërisht për kamerën duhet të shmangen. Fokusi duhet të jetë tek njerëzit gjersa ata janë të angazhuar në aktivitete (p.sh. biseda, protesta, gra në aksion, persona të moshuar në aksione, mbjellje, korrje, nxjerrje të ujit, ndërtimit të diçkaje, në vendin e tyre të punës; të rinjtë në aktivitete, studime, në lojë, etj.) Nëse imazhet e personave, zërat e tyre ose ndonjë tipar tjetër privat personal paraqitet në mënyrë të identifikueshme në rezultatet e komunikimit dhe vizibilitetit, është përgjegjësi e drejtpërdrejt e grantistit të sigurojë deklaratat nga personat në fjalë (ose, në rastin e të miturve, nga personat që ushtrojnë autoritetin prindëror) të dhënies së pëlqimit të tyre për përdorimin e specifikuar të imazhit, zërit ose atributit tjetër personal privat. Grantistët duhet të marrin hapat e duhur për të marrë pëlqimin e tillë në përputhje me dispozitat ligjore të zbatueshme.

Përveç klauzolës së përkrahjes dhe logove të SDC-së, Suedisë dhe KCSF-së, klauzola e përgjegjësisë duhet të paraqitet si më poshtë:

- Nëse publikimi përgatitet vetëm në versionin elektronik në internet, klauzola e përgjegjësisë duhet të paraqitet në faqen e dytë të publikimit.
- Nëse publikimi përgatitet edhe në versionin e shtypur, klauzola e përgjegjësisë duhet të paraqitet në faqen e fundit të publikimit (në faqen e kopertinës së pasme).

² Zbatohet në rastet kur materialet përmbajnë informacion, gjetje dhe/ose rekomandime që rrjedhin nga analiza, hulumtime dhe raporte.

Identiteti vizuel

Logot e SDC-së, Suedisë dhe KCSF-së i dërgohen secilit grantist me rastin e fillimit të zbatimit të grantit nga zyrtari/ja përgjegjës/e nga KCSF. Në rast se paraqiten logo të donatorëve tjerë, ato duhet të paraqiten në përputhje me përqindjen e mbështetjes së tyre për grantin, nga donatori me përqindjen më të lartë në mbështetjen e grantit deri te përqindja më e ulët. Logot duhet të paraqiten në të njëjtin vend dhe në dimensione të ngjashme.

Klauzola e përkrahjes

8 Klauzola e përkrahjes duhet të përdoret në çdo prezantim, njoftim dhe/ose material qlidhje me aktivitetet e përkrahura nga granti.

Në shqip:

Ky aktivitet përkrahet nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë', bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia

Në anglisht:

This activity is supported by Kosovar Civil Society Foundation (KCSF) program 'EJA Kosovo', co-financed by the Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) and Sweden

Në serbisht:

Ovu aktivnost podržava program Kosovske Fondacije za Civilno Društvo (KCSF) „EJA Kosovo”, koji sufinansiraju Švajcarska Agencija za Razvoj i Saradnju (SDC) i Švedska.

Klauzola e përkrahjes për grantistët institucional

Përfituesit e granteve institucionale janë të obliguar që të përdorin klauzolën e mëposhtme të përkrahjes:

Në shqip:

<<Emri i organizatës>> përkrahet nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë', bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia.

Në anglisht:

<<Organization name>> is supported by Kosovar Civil Society Foundation (KCSF) program 'EJA Kosovo', co-financed by the Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) and Sweden.

Në serbisht:

<< Naziv organizacije >> podržan je programom Kosovske Fondacije za Civilno Društvo (KCSF) 'EJA Kosovo', koji sufinansiraju Švajcarska Agencija za Razvoj i Saradnju (SDC) i Švedska.

Klauzola e përgjegjësise

Për publikime si analiza, hulumtime dhe raporte që përmbajnë informacion, gjetje dhe/ose rekomandime, të gjithë grantistët duhet të përdorin klauzolën e përgjegjësise si më poshtë.

Në shqip:

Zhvillimi dhe publikimi i këtij dokumenti është përkrahur nga programi i Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) 'EJA Kosovë', bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Suedia. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e XXX dhe jo domosdoshmërisht paraqet qëndrimet e KCSF-së, SDC-së, apo Suedisë.

Në anglisht:

The development and publication of this document has been supported by Kosovar Civil Society Foundation (KCSF) program 'EJA Kosovo' co-financed by the Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) and Sweden. The content of this document is the sole responsibility of XXX and does not necessarily represent the views of KCSF, SDC or Sweden.

Në serbisht:

Izradu i objavljivanje ovog dokumenta podržala je Kosovska Fondacija za Civilno Društvo (KCSF) programom 'EJA Kosovo', koji sufinansiraju Švajcarska Agencija za Razvoj i Saradnju (SDC) i Švedska. Sadržaj ovog dokumenta odgovornost je XXX i ne predstavlja stavove KCSF-a, SDC-a ili Švedske.